Kronikë

Shkodër/ Shpërthim me tritol në banesën e punonjëses së Doganës! Autori i maskuar dhe me motor hedh tritol në portën e 62-vjeçares e largohet (VIDEO)

Mëngjesin e sotëm një person i maskuar ka hedhur lëndën plasëse në portën e banesës së punonjëses së doganave. Ende nuk dihen motive.Kamerat filmuan autorin teksa largohej me motor.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
25 Mars, 07:55 | **Përditesimi: 25 Mars, 11:18**

Share

SHKODËR- Një shpërthim me tritol ka ndodhur orët e para të mëngjesit në Shkodër, ku një 62-vjeçarje i është vendosur lënda plasëse në derën e banesës.

Ngjarja ka ndodhur në lagjen Tom Kola", rreth orës 03:40 të 25 marsit. Burime për Report Tv bëjnë me dije se autori ka qenë i maskuar dhe me motor. Ai ka hedhur lëndën plasëse në portën e banesës së 62-vjeçares Frida Sala dhe më pas është larguar.

Si pasojë e shpërthimit, fatmirësisht ka vetëm dëme materiale, ndërsa ende nuk dihen arsyet që mund të kenë çuar në vendosjen e tritolit. Report Tv sjell pamje nga vendi i ngjarjes, ndërsa dallohen dëmet në portë, si edhe në një makinë të parkuar aty pranë. Ndërkohë, banesa është e pajisur me dy kamera sigurie, të cilat kanë filmuar edhe momentin kur autori me motor ka hedhur lëndën plasëse dhe është larguar.

LEXO EDHE:
Shkodër/ Rikthehen reshjet e borës në Tamarë e Theth, rrugët të kalueshme (VIDEO)

> *"Rreth orës 03:40, në lagjen "Tom Kola", Shkodër, tek porta e oborrit të banesës së shtetases Frida Sala, 62 vjeçe, është hedhur lëndë plasëse. Si pasojë janë shkaktuar vetëm dëme materiale", njofton policia.*

Në dëshminë e saj në polici, 62-vjeçarja e cila punon në Doganën e Hanit të Hotit, ka deklaruar se nuk ka konflikt me askënd. Ajo thotë se ishte zgjuar herët në mëngjes për të ngrënë syfyr për muajin e Ramazanit, bashkë me djalin e saj, kur kanë dëgjuar shpërthimin.

> *"Jemi zgjuar me djalin në mëngjes për të ngrënë syfyrin për muajin e ramazanit. Kemi dëgjuar shpërthimin së bashku me djalin, dhe menjëherë kemi njoftuar policinë. Nuk kemi konflikt me askënd. Nuk di arsyen pse mund ta kenë bërë", ka deklaruar ajo.*

Policia ka marrë në pyetje edhe djalin e 62-vjeçares, Dori Sala, i cili po ashtu ka deklaruar se nuk ka konflikte me askënd dhe se nuk e di se kush mund të jenë autorët. Ky i fundit punon në një kompani interneti dhe nuk njihet si një person problematik. Vëllai tjetër ndodhet në Itali dhe punon si shofer kamioni.

Policia ka shkuar në vendin e ngjarjes, ndërsa grupi hetimor po kryen veprimet për sqarimin e saj, si edhe identifikimin dhe kapjen e autorit.

Sl.E./S.G/Shqiptarja.com

TAG: shperthim me tritol | Shkoder | Frida Sala | Dori Sala

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Arrestimi i Goros, a besoni se SPAK do bëjë drejtësi për pronat?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Nis ndërtimi i parkingut publik në Shirokë, Rama: Ndikim në shërbimin ndaj turistëve
24 Mars, 19:15

Mbante në makinë fenelina të policisë, nis hetimi për të riun në Shkodër
24 Mars, 15:45

Shkodër/ Hajdutët vjedhin transformatorin e rrjetit elektrik në ujësjellësin e Bërdicës, mbesin pa ujë 4 mijë banorë
24 Mars, 14:27

Kremtohet e Diela e Larit në Shkodër, besimtarët i bashkohen ritualit të bekimit të palmave
24 Mars, 14:12

Vdes 77-vjeçari në Shkodër, dyshohet se rrëshqiti në lumin Buna teksa po hidhte mbeturinat
23 Mars, 17:30

Shkodër/ Shoferit i kontrollojnë makinën, i gjejnë 1100 fara kanabisi gati për shitje! Pasagjeri me 2 radio policie në shtëpi
23 Mars, 12:22

Shkodër, parking i ri publik në Shirokën turistike
22 Mars, 13:05

A është krisur marrëveshja PS-PSD?! Këshilltarët e Tom Doshit në Shkodër bashkojnë 'votat' me Rithemelimin, dështon mbledhja e Këshillit Bashkiak

Ergys Kavaja

21 Mars, 10:04

Shkodër, vijon instalimi i ndriçimit LED në bulevardin 'Bujar Bishanaku'
20 Mars, 19:43

Shkodër, shpallen fituesit e festivalit 'Youth Theatre'! Çuliqi: U evidentuan të rinj të talentuar në aktrim

Ergys Kavaja

20 Mars, 16:41

Tentoi të vriste Selami Brahimin në Shkodër, 68-vjeçari ekstradohet nga Gjermania
20 Mars, 14:30

Tre makina përplasen në aksin Shkodër-Koplik, një fëmijë 2 vjeç në spital
20 Mars, 11:01

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje